



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 1579/2 Prot.

Tiranë, më 23.06.2025

VENDIM

Nr. 33 Datë 23.06 2025

**“PËR
MIRATIMIN E ORËVE TË PUNËS JASHTË ORARIT ZYRTAR PËR STAFIN E
ANGAZHUAR NË TIRANA/EAGLE CUP BY VIAREGGIO CUP 2025”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL dhe në zbatim të nenit 90, pika 1, pika 2, nenit 91, pika 3, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në RSH" i ndryshuar, VKM nr. 568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore", KREU II "Kohëzgjatja e punës dhe orët shtesë", në Vendimin e Rektorit nr. 95, datë 16.04.2025 "Për ngritjen e grupeve të punës për organizimin dhe koordinimin e turneut under 20, Tirana CUP by Viareggio Cup 2025", në Vendimin e Rektorit nr. 123, datë 29.05.2025 "Për organizimin e edicionit të parë të turneut Eagle CUP by Viareggio Cup 2025", në Vendimin e Rektorit nr. 124, datë 02.06.2025 "Për një ndryshim në Vendimin e Rektorit nr. 123, datë 29.05.2025", në shkresën e Rektorit me nr. 1139/1 prot, datë 09.06.2025 "Për një shtesë në pikën dy Vendimit të Rektorit nr. 95, datë 16.04.2025", në shkresën e Rektorit me nr. 1139/2 prot, datë 09.06.2025 "Për një shtesë në Vendimin e Rektorit nr. 95, datë 16.04.2025, si dhe në Vendimin e Rektorit nr. 123, datë 29.05.2025, i ndryshuar", në shkresën e Rektorit me nr. 1139/3 prot, datë 16.06.2025 "Përcillet tabela për realizimin e orëve jashtë orarit për stafin e angazhuar në Tirana/Eagle CUP by Viareggio Cup 2025", si dhe në shkresën e Dekanit të FSHR me nr. 1139/4 prot, datë 16.06.2025 "Orët e angazhimit të fizioterapeutëve - staf i FSHR në Eagle CUP by Viareggio Cup 2025, në relacionin nr 1139/5 prot, datë 18.06.2025, Bordi I Administrimit në mbledhjen e datës 23.06.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pagesës së orëve jashtë orarit zyrtar të punës, për stafin e angazhuar në Tirana/Eagle CUP by Viareggio Cup 2025.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

